



PSH.nr.779/20  
797/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Bejta Commerce”- SH.A- Gjilan dhe “El Bau & Sinani Ing” SH.P.K- Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Teuta-M”SH.P.K-Gjilan & “Rahovica Commerce NT”-Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova”, me nr. të prok: 651-20-2807-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjilan”, më datën: 12.11.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHEN**, si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “Bejta Commerce”- SH.A- Gjilan dhe “El Bau & Sinani Ing” SH.P.K- Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova”, me nr. të prok: 651-20-2807-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjilan”.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull “Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova”, me nr. të prok: 651-20-2807-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjilan”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Bejta Commerce”- SH.A- Gjilan, dhe “El Bau & Sinani Ing” SH.P.K- Gjilan, aprovohen si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## AR SYETIM

Operatorët ekonomik ankues “Bejta Commerce”- SH.A- Gjilan dhe “El Bau & Sinani Ing” SH.P.K- Gjilan, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 08.10.2020 me nr. 779/20 dhe me 12.10.2020 me nr.797/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova” , me nr. të prok: 651-20-2807-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjilan”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-së, te ankesa me nr. 779/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 parag. 1 dhe 2, neni 6 parag.1, neni 7 parag.1.2.4, neni 56 parag.1.1 1.2 dhe 3, neni 59 parag. 4, neni 60 parag.1, nënparag. 1.1, si dhe nenin 69 parag.1 me parag.6 dhe nënparag.1 të LPP-së, te ankesa me nr. 797/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik i prokurimit në raportin e dt: 29.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankues “Bejta Commerce”SHA:

Eksperti Shqyrtues sqaron, se OE ankuesi i lartpërmendur në momentin e marrjes se njoftimit mbi vendimin e AK-së të datës 23.09.2020, po të njëjtën ditë ka kërkuar qasje përmes e-mailit në formë zyrtare, AK ju ka lejuar qasje me datën 25.09.2020 në ora 13:00, mirëpo gjatë qasjes në ofertën e të rekomanduarit, të njëjtit nuk ju ka ofruar asnjë dokument me arsyetimin se OE i rekomanduar ka nënshkruar aneksin për Sekrete



Afariste, gjë që ankuesi është larguar pa vërtetuar asgjë.

Eksperti Shqyrtues tutje sqaron se, gjatë verifikimit të ofertës së OE të rekomanduarit në E-prokurim, sqaron se ky aneks mbi Sekretet Afariste është i nënshkruar, por që duhet të klasifikohet nga AK rëndësia e këtyre dokumenteve sipas LPP-së, andaj ky pretendim i OE ankuesit gjendet i bazuar.

Ndërsa sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit të Dytë "EL Bau & Sinani ING" SHPK:

Pretendimi nr. 1

Në ofertën e dorëzuar nga grupi i OE "TEUTA-M & N.T. RAHOVICA COMERCE" për të plotësuar kërkesën 2 të nenit 9.1&9.2 lidhur me kapacitetin profesional - Mjeshtër i armaturës me diplomë nga qendra për aftësim profesional min. 5 vite pas diplomimit, OE në fjalë ka ofruar dëshmi dokumentare Vërtetimin të lëshuar nga Qendra e Aftësimit Profesional "ARSIMIMI" i dt. 25.01.2005 i cili mban Nr. protokollit 372 dhe dt. E protokollit 10.09.2004 dhe është lëshuar si dëshmi për personin Sokol (Milaim) Jerliu për të vërtetuar se i njëjti ka vijuar kursin prej dt. 10.09.2004 deri me dt. 24.01.2005. Sipas regjistrimit elektronik në ueb faqen publike të Agjencionit të Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovës, rezulton se Qendra e Aftësimit Profesional B.I. mban Numrin e Biznesit 70217821 dhe është e themeluar me datën 30.12.2004 nga Shaban Kastrati, tani më i ndjerë. Prandaj nga një analizë e thjeshtë krahasuese dhe logjike në mes vërtetimit në fjalë dhe të dhënave zyrtare të themelimit të qendrës trajnuese në fjalë vihet deri te përfundimi se personi Sokol Jerliu e ka vijuar trajnimin rreth 81 ditë para se subjekti në fjalë të ketë qenë i themeluar dhe regjistruar si subjekt juridik në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, nenit 4 përcaktohet se veprimtaria ekonomike në Kosovë mund të ushtrohet vetëm nga Shoqëritë Tregtare të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe me ligj. Pra në rastin konkret bazuar në dokumentin në fjalë rezulton se Qendra Trajnuese "ARSIMI" ka zhvilluar aktivitet ekonomik - trajnimi edhe pa u themeluar dhe regjistruar në ARBK e po ashtu në emër të saj gjithnjë duke u bazuar në dokumentin në fjalë ka lëshuar vërtetim për personin Sokol Jerliu me të cilin dëshmohet se i njëjti ka vijuar trajnimin 81 ditë përpara se subjekti në fjalë të ketë qenë se ekzistuar/themeluar. Nisur nga ky fakt në kontekstin ligjor ky dokument nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik dhe si i tillë është NULL (i pavlefshëm). Si rrjedhojë OE në fjalë me dëshminë dokumentare në fjalë lidhur me admiruesin fjalë për shkaqet e cekura nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së të vendosur tek kërkesa 2 të nenit 9.1&9.2 lidhur me stafin profesional për admirues. Andaj në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit/njoftimit të kontratës dhe në bazë të nenit 59.4 të LPP-së AK është dashur që tenderin e OE në fjalë që ta konsiderojë si tender të papërgjegjshëm. Prandaj karshi tenderit të OE fitues vlerësimi është bërë në kundërshtim dhe shkelje të nenit 59.4 dhe nenit 69 par. 6 të LPP-së. Për me tepër konsiderojmë se OE fitues me vetëdije dhe dashje ka konsumuar veprën penale të Falsifikimit të dokumenteve nga neni 390 lidhur me veprën penale Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 395, veprën

penale të Mashtrimit nga neni 323 par .1 dhe par. 2, veprën penale nga neni 415 Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik sipas Kodit Penal të Kosovës Nr. 06/L-074. Ne si palë e dëmtuar nga vendimi i kontestuar i AK-së ngrinim dyshimin se ky dokument është i rremë dhe nga ana e OE në fjalë është përdorur/legalizuar me qëllim që të vihet në lajthim AK për të vërtetuar një çështje të pavërtetë me qëllim të ndikimit në vendimin e AK-së për dhënien e kontratës në mënyrë të paligjshme OE në fjalë. Përkitazi me këtë çështje konsiderojmë se AK është dashur që ta ketë parasysh raportin e monitorimit të këtij aktiviteti nga Rrjeti i OJQ-ve " AVONET" dhe me kohë të merrte masa korrigjuese në pajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit për të parandaluar vënien në lajthim për dhënien e kontratës OE në fjalë i cili me qëllim të eliminimit

të konkurrencës së drejtë dhe të ndershme ka përdorur dokument të rremë për të vërtetuar një çështje të pavërtetë. Po ashtu për të njëjta motive me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik dhe me qëllim të ndikimit në vendimin e AK-së në procedurën e dhënies së kontratës,OE në fjalë ka përsëritur sjelljen/veprën e mëparshme duke i dorëzuar AK-së edhe një dokument të rremë/ falsifikuar i cili është legalizuar me qëllim që ta vërtetojë si të vërtetë dokumentin e pavërtetë - vërtetimin paraprak dhe ta vë në lajthim AK-në në nxjerrjen e vendimit të paligjshëm dhe të padrejtë duke shkelur rregullat e prokurimit publik. Nga qasja zyrtare që e kemi realizuar me dt. 25.09.2020 së bashku me Raportin e Monitorimit të Rrjetit të OJQ-ve "AVONET" lidhur me vlerësimin e këtij aktiviteti, na është bashkëngjitur apo i është përvjedhur AK-së edhe dokumenti Vërtetim i lëshuar me dt. 22.07.2020 lëshuar nga Qendra e Aftësimi Profesional "ARSIMIMI" në emër të drejtorit Shaban Kastrati dhe i vërtetuar me nënshkrimin e tij. Në këtë dokument të falsifikuar qëllimi i të cilit ishte /është që të vihet në lajthim AK për të vërtetuar një çështje të pavërtetë (Vërtetimin e dt.25.01.2000 cilimban Nr.protokolli372 dhe dt. e protokollit 10.09.2004) me qëllim të ndikimit në vendimin e AK-së për dhënien e kontratës në mënyrë të paligjshme OE në fjalë, pohohet fakti/(vërtetohet pretendimi ynë )se Qendra e Aftësimi Profesional "ARSIMIMI" nuk ka qenë e regjistruar në kohën kur është mbajtur trajnimi me kandidatin Sokol Jerliu, meqenëse të gjitha faktet në favor dhe kundër OE fitues dëshmojnë se trajnimi nuk është mbajtur fare. Në të njëjtin dokument i cili ka përmbajtje të rreme (dt. e lëshimit 22.07.2020 është vënë emri, mbiemri dhe nënshkrimi i falsifikuar i personit Shaban Kastrati i cili ka vdekur në muajin shkurt të vitit 2012. Vdekja e të ndjerit Shaban (Haxhi) Kastrati i lindur me dt. 02.04.1960 vërtetohet në bazë të Certifikatës së vdekjes me Nr. serik V 10354523, Numri i referencës 19/2012RV/19001, sipas të cilës konstatohet se i ndjeri ka vdekur me datën 23.02.2012. Duke ndjerë keqardhje nga aspekti njerëzor që detyrohemi ta përdorim këtë fakt si pretendim ankimor, e konsiderojmë teper shqetësues edhe jo njerëzor e veprimin e OE"TEUTA-M" e cila për të arritur qëllimet e saj të paligjshme për përfitime financiare abuzon edhe me persona të vdekur duke falsifikuar të dhënat dhe nënshkrimin e personit të vdekur Shaba Kastrati që këtë dokument ta shfrytëzojë si të vërtetë me qëllim ta vëjë në lajthim AK-në me një çështje të pavërtetë vetëm për ta nxitur ashtu siç e ka nxitur për të marrë



vendim të padrejtë dhe të paligjshëm. Shtrohet pyetja se çfarë dhimbje shpirtërore kishte me përjetua familja e të ndjerit Shaban Kastrati në rast se vjen deri te informata se njerëzit /kompanitë si në rastin konkret OE TEUTA-M për ta arritur një qëllim të ligë e të paligjshëm të përfitimit material duke legalizuar një dokument të pavërtetë abuzon me emrin dhe mbiemrin e një të vdekuri 8 vite më parë. AK-ja duke shfrytëzuar nenin 59.2 dhe nenin 72 të LPP-së duhet të kërkojë sqarime për përmbajtjen e këtyre dy dokumenteve, për të parin nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovës ,dhe për të dytin nga Agjencioni i Regjistrimit Civil duke kërkuar për të verifikuar informatën (certifikatën e vdekjes) mbi vdekjen e personit Shaban Kastrati të cilën e kemi bashkëngjitur me ankesë si provë materiale. Kërkojmë nga eksperti shqyrtues i angazhuar për trajtimin e kësaj lënde që në ekspertizën e kryer lidhur me këtë pretendim të analizojë dhe përshkruajë në aspektin faktik të gjeturat nga provat e dyshuara si të falsifikuara: Vërtetimin e dt. 25.01.2005 i cili mban Nr. protokollit 372 dhe dt. e protokollit 10.09.2004 dhe Vërtetim i lëshuar me dt. 22.07.2020 nga Qendra e Aftësimit Profesional "ARSIMIMI" me emër dhe mbiemër dhe nënshkrim të ndjerit Shaban Kastrati. Kërkojmë mos të përdoret praktika që në shumë raste aplikohet duke konstatuar se "përgjegjësi të ekspertit shqyrtues t'i verifikojë këto pretendime /dyshime, këto dyshime mund t'i paraqes në organet kompetente". Nuk po kërkojmë nga eksperti të përcaktojë fajësinë ose pafajësinë e askujt dhe as përcaktimin dhe vlerësimin/të provuarit në aspektin penal. Këto dy prova materiale janë të rëndësisë së veçantë edhe në procedurën e prokurimit (shih nenin 1, nenin 99, nenin 52.7, nenin 132 të LPP-se), janë të rëndësishme pasi që ndërlihen me të provuarit faktik për shkeljet e pretenduara nga vendimi kontestues i një autoriteti kontraktues, dëmin e shkaktuar apo që rrezikon të shkaktohet pjesëmarrësit- OE (shih nenin 104 të LPP-së , parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike dhe transparente të fondeve publike (shih nenin 1 të LPP-së)ETJ. Po ashtu meqenëse AK-ja nuk e ka marrë seriozisht këtë çështje, i propozojmë OSHP-së që pas vërtetimit të këtyre fakteve, në pajtim me nenin 99 të LPP-së të fillojë procedurën ex officio për diskualifikimin OE "TEUTA - M & RAHOVICA COMERCE" nga pjesëmarrja në çfarëdo prokurimi publik dhe në anën tjetër ndaj personave përgjegjës të OE"TEUTA-M&RAHOVICA COMERCE", t'i drejtohet prokurorisë kompetente duke ia përcjellur informatën dhe shkresat e lëndës (dokumentet të cilat dyshohen se janë të falsifikuara) dhe janë përdorur në këtë aktivitet prokurimi e shumë aktivitet tjera siç është rasti edhe në aktivitetin me titull: "Zhvillimi socio ekonomik në Komunë e Kamenicës përmes ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza në fshatin Koretin", i iniciuar nga AK- Kamenicë. Eksperti Shqyrtues gjatë shqyrtimit të lëndës dhe shkresave të dërguara lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe pretendimet kundër OE të rekomanduara, Eksperti fillimisht ka kërkuar nga AK me e-mail, që të bashkëngjisin dy dëshmi të cilat OE ankuesi i ka faktuar me ankesë: Email i dërguar nga Eksperti Shqyrtues më 26.10.2020 ora 9:32AM tek Zyra e Prokurimit -AK Kërkesë për dokumente shtesë A.P 651-20-2807-5-2-1 Blerina Huruglica Prokurimi Gjilan;Salih Kqiku; Të nderuar, Jemi duke e shqyrtuar ankesë e OE ankuesit "EL Bau & Sinani ING"SH.P.K, lidhur me aktivitetin e

prokurimit me numër 651-20-2807-5-2-1 përkatësisht at me titull "Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova". Në ankesën e GOE ankues janë të bashkangjitura dy dëshmi, meqë në e-prokurim nuk janë të publikuara, dhe në mënyrë që të jemi sa më objektiv në shqyrtimin e ankesës, lusim që dokumentet e poshtë shënuara të na bashkëngjiti me e-mail: -Vërtetimi nga OE "Teuta-M" si i Certifikuar Admirues Sokol (Milaim) Jerliu, i lëshuar me 22.07.2020 nga Qendra e Aftësimit Profesional, -Raporti i Vlerësimit të monitorimit të prokurimit nga OJQ-ve"AVONET"

Faleminderit për bashkëpunim, Punë të mbarë, Blerina Huruglica Ekspert Shqyrtues Organi Shqyrtues i Prokurimit Prishtinë.

Eksperti Shqyrtues sqaron tutje, kemi pritur që të na përgjigjet AK, por pa sukses, pastaj më datën 27.10.2020 rreth ores 09:15 AM pra ditën e nesërme i kam kontaktuar përmes telefonit zyrtar, ku është lajmëruar zyrtari në zyrën e prokurimit dhe më ka thënë se do ti përgjigjen e-mailit dhe kërkesës sonë, por prapë nuk kemi pranuar përgjigje ende nga AK, andaj meqë afati për dorëzimin e ekspertizës është afruar, atëherë vazhduam me dëshmitë e pranuar nga OE ankuesi. Eksperti Shqyrtues tutje sqaron se në dëshmitë e bashkangjitura nga OE ankuesi përkatësisht Raporti monitorimit për këtë aktivitet i OJQ-ve "AVONET" ka bërë gjetje po ashtu për këtë pretendim citat:"

AVONET ka bërë monitorimin e ofertave të dosjeve të operatorëve ekonomik në projektin e tenderit "Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova" me nr. prokurimit: 651-20-2807-5-2-1, ku kemi gjetur disa nga të gjeturat si janë në vijim:

Operatori Ekonomik "Teuta" shpk për të plotësuar kërkesën lidhur me kriterin mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkesat mbi mundësitë teknikedhe/ose profesionale kërkesa me nr. 2: që 1 ( një ) mjeshtër i armatures me diplom nga qendra për aftësim profesional minimum 5 vite pas diplomimit ku OE "Teuta" për të plotësuar këtë pikë ka ofruar Çertifikaten të lëshuar nga kompania ARSIMIMI për personin Sokol (Milaim )Jerliu e protokoluar me datën 10.09.2004 me nr Protokoli 372 ku në vërtetimin ceket se i lartëpërmenduri ka vijuar kurisn prej dates 10.09.2004 deri me me datën 24.01.2005 ndërsa pas verifikimit ne <https://arbk.rks.gov.net/page.aspx?id=1,38,63201> del se e njeja kompani është hapur me datën 30.12.2004 qe i bi se Çertifikata e paraqitur është para datës së regjistrimit dhe është e dyshuar si dokumentacion i falsifikuar.

Eksperti Shqyrtues tutje sqaron se OE i rekomanduari ka sjellë Diplomën e cila është e lëshuar në kohën kur kjo qendër ka qenë vetëm si OJQ gjerë sa në kërkesën e AK-së në DT kërkohet që:" 1 ( një ) Mjeshtër i armaturës me diplomë nga qendra për aftësim profesional min. 5 vite pas diplomimit" Pra OE i rekomanduar nuk e përmbushë kriterin siç kërkohet në DT,gjithashtu ky pretendim lidhur për këtë kriter është shqyrtuar nga OSHP për rastet të ngjashme dhe ka një vendim (SHIH lartë tek VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME).

Eksperti tutje sqaron se,po ashtu ky i fundit ju ka dërguar edhe një vërtetim të lëshuar me datë 22.07.2020 nga Qendra e Aftësimit Profesional e cila është e nën shkruar nga Shaban Kastrati e që i ndjeri tashmë ka vdekur para 8 viteve! Për derisa është dashur që AK-ja duke shfrytëzuar nenin 59.2 dhe nenin 72 të LPP-së



të kërkojë sqarime për përmbajtjen e këtyre dy dokumenteve, për të parin nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovës, dhe për të dytin nga Agjencioni i Regjistrimit Civil duke kërkuar për të verifikuar informatën (certifikatën e vdekjes) mbi vdekjen e personit Shaban Kastrati të cilën OE ankuesi e ka bashkëngjitur me ankesë si provë materiale. Eksperti Shqyrtues po ashtu ka hulumtuar tek ARBK me nr të biznesit 70217821 lidhur me Qendrën e Aftësimit Profesional në mënyrë që të vërtetoj se a ekziston biznesi me këtë numër dhe po ashtu pronarin me nr personal, dhe sqaron se qendra është e themeluar me 30.12.2004 dhe përkon po ashtu edhe numri personal me të ndjerin Shaban Kastrati.

### Qendra E Aftësimit Profesional Arsimimi B.I.

<b>Emri i biznesit</b>	Qendra E Aftësimit Profesional Arsimimi B.I.
<b>Emri tregtar</b>	Qendra e Aftësimit Profesional „Arsimimi“
<b>Lloji biznesit</b>	Biznes individual
<b>Numri unik identifikues</b>	///
<b>Numri i biznesit</b>	70217821
<b>Numri fiskal</b>	600381529
<b>Numri certifikues KTA</b>	///
<b>Numri punëtorëve</b>	3
<b>Data e regjistrimit</b>	30/12/2004
<b>Komuna</b>	Prishtinë
<b>Adresa</b>	Prishtinë, 40, Bajram Bahtiri
<b>Telefoni</b>	///
<b>E-mail</b>	///
<b>Kapitali</b>	00.00€
<b>Statusi në ARBK</b>	Regjistruar
<b>Statusi në ATK</b>	///

### Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Vedat	Krajkova	Drejtor.	

### Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Shaban Kastrati	00.00€	0.00%

### Njësitë

Nr	Numri i njësisë	Emri	Vendi
----	-----------------	------	-------

### Aktivitet/et

Kodi	Përshkrimi	Tipi
8559	Arsimi tjetër p.k.t.	Primarë

QENDRA E AFTËSIMIT PROFESIONAL  
PROFFESIONAL EDUCATION CENTER  
"ARSIMIMI" - PRISHTINË

VËRTEFTIM

Me këtë vërtetim vërtetojmë se SOKOL (MILAIM) JERLIU ka vijuar kursin prej datës: 10.09.2004 deri më 24.01.2005 për profilin arsimor ARMIRUES.

Gjatë trajnimit Qendra jonë e Aftësimit nuk ka qenë e Regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të bizneseve të Kosovës (ARHK), mirëpo ishte në procedura të regjistrimit, ndërsa aktivitetet e saja ujo i mbante me rregull me të gjithë kandidatët e saj si OJQ, ku njëri prej kandidateve të saj ishte edhe Sokol Jerliu.


Diplomimi i kandidatit në fjalë është bërë me datë: 24.01.2005 me nr.regjistrimit: 364 dhe protokolit: 372, pas regjistrimit të Qendrës sonë më datë: 30/12/2004 me numër të Biznesit: 70217821, dhe numër Certifikues: 600381529 me seli në Prishtinë.

Më datë:

22.07.2020

Drejtori:

Shaban Kastrati



Info: Mob: 044/198-273

Prof: Nazmi Ajeti





Republika e Kosovës  
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo

MINISTRIA E RINDOZTË TË SHËNIESË DHE TË REGJISTRIMIT / MINISTROV ZA ZDRAVLJE I POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

**CERTIFIKAT E Vdekjes**  
**IZVOD IZ REGISTRA SMRTI**  
**DEATH CERTIFICATE**

Numri i dokumentit  
 Dokument number  
 V 10354523

Komuna, Qytet dhe Qendres Qytet Qyteti i Prishtinës Municipality, City of Pristina	Prishtinë, Prishtinë	Numri i regjistrimit Dokument number	19/2012RV/19001
Data e regjistrimit Data e regjistrimit Registration date	20/03/2013	Numri i regjistrimit Dokument number	587
Emri Emri Name	Shaban		
Mbiemri Përmirë Surname	Kastrati		
Data e lindjes Data e lindjes Date of birth	02/04/1960	Sex Paj Sex	M <input checked="" type="checkbox"/> F <input type="checkbox"/>
Vendi i lindjes Afërsisht vendi i lindjes Place of birth	Kishnarekë		
Numri personal IDN broj Personal number	2 0 1 5 6 1 5 4 9 7		
Shtetësia Detyruesorja Citizenship	Kosovar		
Adresa e shtëpisë së rrethit Adresa e shtëpisë së rrethit Last place of residence	RR. SUBOTICËS NR. 13, Kishnarekë		
Emri i nënës / babës Matë / babë Name and surname of mother	Haxhi Kastrati		
Emri i nënës / vëllit Matë / vëll Name and surname of mother	Naile Kastrati		
Qendri i rrethit dhe të vëllit / nënës Rrethi dhe shteti i nënës / nënës Matë / babë / nënë / vëll / nënë	i.e. matërisht		
Emri i nënës / vëllit dhe nënës / vëllit Nëna dhe shteti i nënës / vëllit	Elçjeta Kastrati		
Data e vdekjes Data e vdekjes Date of death	23/02/2013		
Vendi i vdekjes Afërsisht vendi i vdekjes Place of death	Prishtinë		
Komuna, Qytet dhe Qendres Qytet Qyteti i Prishtinës Municipality, City of Pristina	Gjilan, Gjilan	Emri i regjistrimit Matërisht Register	Agron Idrizi
Data e regjistrimit Data e regjistrimit Issuing date	23/09/2020	Emri i regjistrimit Paj Signature	

010467549

Nga të cekurat më lartë Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimi i OE ankuesit është i bazuar!

Pretendimi rr. 2

Parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim OE "EL-BAU&SINANIING" është diskualifikuar nga dhënia e kontratës me arsyetimin se tenderi ynë nuk ishte tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët në mesin e tenderëve që i plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ky arsyetim nuk qëndron për faktin se tenderi i dorëzuar nga ana e ankuesit i ka plotësuar të gjitha kriteret e përzgjedhjes siç

janë kërkuar në dosjen e tenderit/njoftim për kontratë si dhe në mesin e të gjithë tenderuesve e ka plotësuar kriterin kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët siç përcaktohet me nenin 60 i LPP-së. Mirëpo për shkak se AK gjatë procesit të vlerësimit nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike karshi OE fitues dhe nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të LPP-së të nenit 59 dhe 60 lidhur me nenin 1, nenin 6 dhe nenin 7 të LPP-së ka nxjerrur vendim të padrejtë dhe të paligjshëm me të cilin e ka dëmtuar dhe ia ka cenuar të drejtën e ligjshme për t'u shpërblyer me kontratë OE ankues. Andaj duke u bazuar në argumentet dhe provat e paraqitura më lartë, kërkojmë AK-së që procedura e shqyrtimit të lëndës të bëhet në mënyrë të drejtë dhe pa diskriminim duken ndërmarrë masa korrigjuese në mënyrë proporcionale me shkeljet e paraqitura në ankesë, duke marrë parasysh pasojat dhe interesat që mund t'i dëmtohen ankuesit, në atë mënyrë që të mënjanohen gabimet dhe veprimet korrigjuese të jenë në pajtueshmëri me gjendjen faktike dhe kërkesat ligjore nga neni 59 dhe 60 i LPP-së.

Eksperti Shqyrtues këtë pretendim të OE ankuesit e gjen të bazuar, për arsye se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave nga AK nuk është bërë konform LPP\_së, me faktin se OE i rekomanduar nuk e përmbushë kriterin tek kërkesa 2-Kapaciteti teknik dhe profesional. Andaj OE ankuesi mendoj se është i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

#### Pretendimi nr. 3

Me datën 25.09.2020 parashtruesi ka parashtruar tek AK kërkesë për qasje zyrtare në dosjen origjinale të OE "Teuta-M". Qasja nuk është siguruar në pajtim me nenin 10 par. 3, par.4 dhe par. 5 të LPP-së dhe nenin 11 të LPP-së. Nuk na është ofruar qasja në dokumentet që kemi shprehur interesim me arsyetimin se janë të klasifikuara sipas kërkesës së Sekret Afarist sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së. Mirëpo në anën tjetër AK nuk ka prezantuar asnjë vendim që është nxjerrë që këto informata janë klasifikuar si informata sekrete afariste siç përcaktohet me nenin 11 të LPP-së. Na është dhënë qasje vetëm në dokumentet të cilat i cekëm më lartë . Me këtë rast duke u bazuar në faktet e prezantuara dhe në zbatimin e drejtë të bazës ligjore nga dispozitat e cekura, vihet në përfundim se AK ka shkelur nenin 10 par 3, 4, 5 dhe nenin 11 të LPP-së.

Eksperti Shqyrtues pretendimin e gjen pjesërisht të bazuar, për faktin se në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet Aneksi i nënshkruar mbi Informatat Sekrete Afariste, por që AK duhet ti klasifikojë këto dokumente.

#### Pretendimi nr. 4

Lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues, AK- Komuna e Gjilanit, me datë 30.09.2020 ka nxjerrë Vendim me të cilin e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim dhe e ka lënë në fuqi vendimin e dt. 23.09.2020 për dhënien e kontratës OE TEUTA-M & RAHOVICA COMERCE". Vendimi i kontestuar përmban të meta thelbësore të dispozitave të legjislacionit të prokurimit për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet



ligjshmëria e tij. Organi i cili merr pjesë në procedurën administrative, në rastin konkret AK- Komuna e Gjilanit, detyrohet që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.

Në pretendimin ankimor Nr. 1 e kemi vënë në dijeni dhe pajisur AK-në me informata dhe fakte nga të cilat dëshmohet se OE fitues "TEUTA -M & RAHOVICA COMERCE" në tenderin e dorëzuar ka paraqitur dokument të falsifikuar me të dhëna të rreme me qëllim të mashtrimit, vënies në lajthim dhe ndikimit në nxjerrjen e vendimit të AK-së për dhënien e kontratës në mënyrë të paligjshme në dobi të OE në fjalë.

Në pjesën e arsytimit të vendimit të kundërshtuar nuk është shqyrtuar fare ky pretendim ankimor përveç me një formulim të përgjithshëm dhe abstrakt, pas asnjë arsytimi faktik dhe ligjor është konstatuar se të gjitha pretendimet ankimore bien poshtë dhe mbetet në fuqi njoftimi për dhënien e kontratës.

Në arsytimin e vendimit nuk janë dhëna arsye, fakte dhe shkaqe vendimtare gjatë vlerësimit të objektit të kërkesës për rishqyrtim, bazën ligjore pse është e zbatueshme në rastin konkret, që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit i cili konsiderojmë se është i paligjshëm dhe i padrejtë. Pra me këtë vendim nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike me ç'rast ka rezultuar edhe shkelja thelbësore e dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik pikërisht nenin 59 dhe 60 lidhur me nenin 1 dhe 7 të LPP-së. Prandaj ky vendim përmban shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së pikërisht nenit 108/A par. 9 (nenit 8.2 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim dhe ankesave), Ligjit të Përgjithshëm të Procedurës Administrative, pikërisht nenit 48, që kanë të bëjnë me mënyrën e nxjerrjes së akteve të tilla administrative, arsytimi e tyre dhe dhe provat që mbështesin këto vendime. Eksperti Shqyrtues këtë pretendim e gjen të bazuar, me faktin se AK nuk ka dhënë asnjë sqarim lidhur me pretendimet, po ashtu AK nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore të cilat ndikojnë direkt në vendimmarrje!



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GJILANI  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GJILAN BELEDIYESI

### Njësia e Prokurimit

Gjiçan, me datë: 30.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunitetit të Gjiçanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligje Nr. 04/L-257, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullatës për Paraqitjen e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim nr. 1 të datës 23.09.2020, të paraqitur nga Grupi i OE "EL BAU & SINANI ING" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova" me nr të prokurimit 651-20-2007-6-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 20 026 511 nxjerr:

### V E N D I M

**Rëndësishëm:** kërkesa për rishqyrtim e Grupit të OE "EL BAU & SINANI ING" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova" me nr të prokurimit 651-20-2007-6-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 20 026 511 e datës 23.09.2020 kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 23.09.2020 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

1. AK - Komuna e Gjiçanit vendos të vazhdojë sipas Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 23.09.2020
2. Ky vendim lyp të bëjë ditën e mbledhjes dhe da të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <http://e-prokurimi.ks.gov.net>.

Arsyetim

Grupi i OE "EL BAU & SINANI ING" SH.P.K me datë 23.09.2020 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova" me nr të prokurimit 651-20-2007-6-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 20 026 511 Autoriteti Kontraktues me datë 30.09.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar të gjitha pikat ankimore të Grupit të OE "EL BAU & SINANI ING" SH.P.K. ka të gjitha pretendimet ankimore bien poshtë dhe mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Gjithashtu ja shpjegojmë që megjithatë pas shqyrtimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 30.09.2020, kemi pranuar ankesën nga ju ku kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e OE i cili mbete siguarë firmës për këtë shqyrtim.  
AK ka konstatuar që Grupi i Operatorëve Ekonomikë K.N.T.SH " Teuta - M " Sh.p.k; N.T "Rahovica Commerce", ka të gjitha ankesat 3 herë për shkak të shkeljeve - laparimit ekonomik financiar si dhe laparimit të tekut dhe profesional, në arsyetimin se të dhënat prej këtij tenderi -projekti mund të përfitohet për tender-projekte tjera.  
AK përmes emailit me dt 24.09.2020 ka kërkuar nga GJILAN K.N.T.SH, " Teuta - M " Sh.p.k; N.T "Rahovica Commerce" që të jo lejojnë qasje e plotë OE të cilat janë të interesuar. Me dt. 25.09.2020 "TEUTA-M" SH.P.K cila përgjigjet përmes emailit si më poshtë:

*Ejti ne fund ne i perket kerkeses tuaj per lqyrtim ne qasje ne dokumentacion, ne me vendimje e kemi shqyrtuar dokumentacionin e ankesat ne i qyrtim dhe ne te jepim per shkak shkelje dhe shkeljeve te dokumentacionit i ankesat pa te dorozhet ne permban shkelje, dhe per bote me mund te lqyrtim Gjithashtu mbi gjithe ne bazojme ne shkeljet e shkeljet tuaj si prokurim ne informojme kur kemi vendimje qe neve si OE te na shpjgojmë firmen ne tenderin ne fjalë.*

Autoriteti Kontraktues duke u bazuar në Ligjin e LPP në Neni 11 paragrafi 3.3.1.2.2.3 (Informatat Sekrete Afarite), ka respektuar kërkesën e Grupit i Operatorëve Ekonomikë K.N.T.SH " Teuta - M " Sh.p.k; N.T.

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lart AK- Komuna e Gjiçanit i hapë postat të gjitha pretendimet e paqja ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thirrë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Kërkohet parashik:**  
Kështu kërj vendim, arsyetim mund të paraqesëshme për OSHP-në. Ankesa për OSHP-në duhet të dorozhet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje Operativit Ekonomik:  
Zyrtarë të Kryetarit të Komunitetit  
Të gjitha palëve të interesuara,  
Aktiviteti Komunitetit.

Izet Krasniqi  
Zyrtarë  
*[Signature]*

Eksperti Shqyrtues si konkludim sqaron se pretendimet e dy ankuesve të lartpërmendur gjenden të bazuara, ku rekomandohet që Njoftimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe se aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, procesi i rivlerësimit të bëhet konform LPP-së dhe RRUOPP-së, duke marrë masa korrigjuese për ta rregulluar aktivitetin e prokurimit në pajtueshmëri me këtë ligj.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesat e OE ankuesve të aprovohen dhe se lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 29.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 02.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “Bejta Commerce” SH.A- Gjilan, me datë 31.10.2020 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues

Për OSHP-në, me datë 26.09.2020. Nga Bejta Commerce SH.A. Në lidhje me mendimin e ekspertit të caktuar nga OSHP për ankesën për tenderin: Numri i Prokurimit : 651-20-2807-5-2-1 me titull Rekonstruimi i rrugës Haqif Tetova. Në shumicën e gjasave të analizuar nga eksperti shqyrtues jemi te njëjtit mendim dhe e pranojmë mendimin e ekspertit që procedura e vlerësimit të tenderit ka pasur shkelje. Nuk e pranojmë mendimin e ekspertit të pika nr. 2 e ankesës nga OE “El Bau & Sinani Ing”, ku eksperti thotë citoj: Andaj OE ankuesi (në këtë rast El Bau & Sinani Ing) mendoj se është i përgjegjshëm me çmim me te ulet , këtë mendim nuk e pranojmë dhe nuk pajtohem me te dhe mund të ju sqaroj se Kompania El Bau & Sinani Ing ka qene me çmim 234.525.25 euro , ndërsa ne Kompania Bejta Commerce SH.A. jemi me çmim 225.264.75 euro qe i bie se jemi me te lire për 9.260.50 euro, Si dhe jemi te përgjegjshëm dhe i plotësojmë te gjitha kushtet e kërkuara ne FDT. Eksperti shqyrtues nuk është dashur të lëshohet ne vlerësime për te cilat nuk ka njohuri dhe për te cilat nuk është thirrur nga OSHP-ja ,eksperti nuk ka qene i thirrur qe te jep mendim te këtij lloji sepse, mendimi i pa analizuar krijon konfuzion dhe na shtyn te mendojmë se eksperti ka analizuar nen presion ose i ndikuar. Me respekt Bejta Commerce SH.A.

Operatori Ekonomik “El Bau & Sinani Ing” SH.P.K.-Gjilan ,me datë 03.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.



Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Bejta Commerce" SHA, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankuesi në momentin e marrjes së njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës 23.09.2020, po të njëjtën ditë ka kërkuar qasje përmes e-mailit në formë zyrtare, AK i ka lejuar qasje me datën 25.09.2020 në ora 13:00. Mirëpo, gjatë qasjes në ofertën e të rekomanduarit, të njëjtit nuk ju ka ofruar asnjë dokument me arsyetimin se OE i rekomanduar ka nënshkruar aneksin për Sekrete Afariste, gjë që ankuesi është larguar pa vërtetuar asgjë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se gjatë verifikimit të ofertës së OE të rekomanduarit në E-prokurim, sqaron se ky aneks mbi Sekretet Afariste është i nënshkruar, por që duhet të klasifikohet rëndësia e këtyre dokumenteve sipas LPP-së nga AK. Andaj, ky pretendim i OE ankuesit gjendet i bazuar.

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankues "EL Bau & Sinani ING" SHPK, se në ofertën e dorëzuar nga grupi i OE "TEUTA-M & N.T. RAHOVICA COMERCE" për të plotësuar kërkesën 2 të nenit 9.1&9.2 lidhur me kapacitetin profesional - Mjeshtër i armaturës me diplomë nga qendra për aftësim profesional min. 5 vite pas diplomimit, OE në fjalë ka ofruar dëshmi dokumentare Vërtetimin të lëshuar nga Qendra e Aftësimit Profesional "ARSIMIMI" i dt. 25.01.2005 i cili mban Nr. protokollit 372 dhe dt. E protokollit 10.09.2004 dhe është lëshuar si dëshmi për personin Sokol (Milaim) Jerliu për të vërtetuar se i njëjti ka vijuar kursin prej dt. 10.09.2004 deri me dt. 24.01.2005. Sipas regjistrimit elektronik në ueb faqen publike të Agjencionit të Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovës, rezulton se Qendra e Aftësimit Profesional B.I. mban Numrin e Biznesit 70217821 dhe është e themeluar me datën 30.12.2004 nga Shaban Kastrati, tani më i ndjerë. Prandaj, nga një analizë e thjeshtë krahasuese dhe logjike në mes vërtetimit në fjalë dhe të dhënave zyrtare të themelimit të qendrës trajnuese në fjalë vihet deri te përfundimi se personi Sokol Jerliu e ka vijuar trajnimin rreth 81 ditë para se subjekti në fjalë të ketë qenë i themeluar dhe regjistruar si subjekt juridik në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, nenit 4 përcaktohet se veprimtaria ekonomike në Kosovë mund të ushtrohet vetëm nga Shoqëritë Tregtare të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe me ligj. Pra, në rastin konkret bazuar në dokumentin në fjalë rezulton se Qendra Trajnuese "ARSIMI" ka

zhvilluar aktivitet ekonomik - trajnimi edhe pa u themeluar dhe regjistruar në ARBK, e po ashtu në emër të saj gjithnjë duke u bazuar në dokumentin në fjalë ka lëshuar vërtetim për personin Sokol Jerliu me të cilin dëshkohet se i njëjti ka vijuar trajnimin 81 ditë përpara se subjekti në fjalë të ketë qenë se ekzistuar/themeluar. Nisur nga ky fakt në kontekstin ligjor ky dokument nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik dhe si i tillë është NUL (i pavlefshëm). Si rrjedhojë, OE në fjalë me dëshminë dokumentare në fjalë lidhur me admiruesin fjalë për shkaqet e cekura nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së të vendosur tek kërkesa 2 të nenit 9.1&9.2 lidhur me stafin profesional për admirues. Andaj, në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit/njoftimit të kontratës dhe në bazë të nenit 59.4 të LPP-së, AK është dashur që tenderin e OE në fjalë që ta konsiderojë si tender të papërgjegjshëm. Prandaj, karshi tenderit të OE fitues vlerësimi është bërë në kundërshtim dhe shkelje të nenit 59.4 dhe nenit 69 par. 6 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim OE "EL-BAU&SINANIING" është diskualifikuar nga dhënia e kontratës me arsyetimin se tenderi ynë nuk ishte tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët në mesin e tenderëve që i plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ky arsyetim nuk qëndron për faktin se tenderi i dorëzuar nga ana e ankuesit i ka plotësuar të gjitha kriteret e përzgjedhjes siç janë kërkuar në dosjen e tenderit/njoftim për kontratë si dhe në mesin e të gjithë tenderuesve e ka plotësuar kriterin kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët siç përcaktohet me nenin 60 i LPP-së. Mirëpo për shkak se AK gjatë procesit të vlerësimit nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike karshi OE fitues dhe nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të LPP-së të nenit 59 dhe 60 lidhur me nenin 1, nenin 6 dhe nenin 7 të LPP-së ka nxjerrur vendim të padrejtë dhe të paligjshëm me të cilin e ka dëmtuar dhe ia ka cenuar të drejtën e ligjshme për t'u shpërblyer me kontratë OE ankues. Andaj duke u bazuar në argumentet dhe provat e paraqitura më lartë, kërkojmë AK-së që procedura e shqyrtimit të lëndës të bëhet në mënyrë të drejtë dhe pa diskriminim duken ndërmarrë masa korrigjuese në mënyrë proporcionale me shkeljet e paraqitura në ankesë, duke marrë parasysh pasojat dhe interesat që mund t'i dëmtohen ankuesit, në atë mënyrë që të mënjanoen gabimet dhe veprimet korrigjuese të jenë në pajtueshmëri me gjendjen faktike dhe kërkesat ligjore nga neni 59 dhe 60 i LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues këtë pretendim të OE ankuesit e gjen të bazuar, për arsye se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave nga AK nuk është bërë konform LPP-së, me faktin se OE i rekomanduar nuk e përmbushë kriterin tek kërkesa 2-Kapaciteti teknik dhe profesional.

Sa i përket pretendimit tjetër, me datë 25.09.2020 OE ankues ka parashtruar tek AK kërkesë për qasje zyrtare në dosjen origjinale të OE "Teuta-M". Qasja nuk është siguruar në pajtim me nenin 10 par. 3, par.4 dhe par. 5 të LPP-së dhe nenin 11 të LPP-së. Nuk na është ofruar qasja në dokumentet që kemi shprehur interesim me



arsyetimin se janë të klasifikuara sipas kërkesës së Sekret Afarist sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së. Mirëpo në anën tjetër AK nuk ka prezantuar asnjë vendim që është nxjerrë që këto informata janë klasifikuar si informata sekrete afariste siç përcaktohet me nenin 11 të LPP-së. Na është dhënë qasje vetëm në dokumentet të cilat i cekëm më lartë . Me këtë rast duke u bazuar në faktet e prezantuara dhe në zbatimin e drejtë të bazës ligjore nga dispozitat e cekura, vihet në përfundim se AK ka shkelur nenin 10 par 3, 4, 5 dhe nenin 11 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi është pjesërisht të bazuar për faktin se në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet Aneksi i nënshkruar mbi Informatat Sekrete Afariste por që AK duhet ti klasifikojë këto dokumente.

Në lidhje me pretendimin e radhës që ka të bëjë me kërkesën për Rishqyrtim të OE ankues, AK- Komuna e Gjilanit, me datë 30.09.2020 ka nxjerrë Vendim me të cilin e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim dhe e ka lënë në fuqi vendimin e dt. 23.09.2020 për dhënien e kontratës OE TEUTA-M & RAHOVICA COMERCE". Vendimi i kontestuar përmban të meta thelbësore të dispozitave të legjislacionit të prokurimit për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Organi i cili merr pjesë në procedurën administrative, në rastin konkret AK- Komuna e Gjilanit, detyrohet që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Në pretendimin ankimor Nr. 1 e kemi vënë në dijeni dhe pajisur AK-në me informata dhe fakte nga të cilat dëshmohet se OE fitues "TEUTA -M & RAHOVICA COMERCE" në tenderin e dorëzuar ka paraqitur dokument të falsifikuar me të dhëna të rreme me qëllim të mashtrimit, vënies në lajthim dhe ndikimit në nxjerrjen e vendimit të AK-së për dhënien e kontratës në mënyrë të paligjshme në dobi të OE në fjalë. Në pjesën e arsyetimit të vendimit të kundërshtuar nuk është shqyrtuar fare ky pretendim ankimor përveç me një formulim të përgjithshëm dhe abstrakt, pas asnjë arsyetim faktik dhe ligjor është konstatuar se të gjitha pretendimet ankimore bien poshtë dhe mbetet në fuqi njoftimi për dhënien e kontratës. Në arsyetimin e vendimit nuk janë dhëna arsye, fakte dhe shkaqe vendimtare gjatë vlerësimit të objektit të kërkesës për rishqyrtim, bazën ligjore pse është e zbatueshme në rastin konkret, që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit i cili konsiderojmë se është i paligjshëm dhe i padrejtë. Pra me këtë vendim nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike me ç'rast ka rezultuar edhe shkelja thelbësore e dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik pikërisht nenin 59 dhe 60 lidhur me nenin 1 dhe 7 të LPP-së. Prandaj ky vendim përmban shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së pikërisht nenit 108/A par. 9 (nenit 8.2 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim dhe ankesave), Ligjit të Përgjithshëm të Procedurës Administrative, pikërisht nenit 48, që kanë të bëjnë me mënyrën e nxjerrjes së akteve të tilla administrative, arsyetimi e tyre dhe dhe provat që mbështesin këto vendime.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i bazuar për faktin se AK nuk ka dhënë asnjë sqarim lidhur me pretendimet. Po ashtu, AK nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore sipas pikave ankimore.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit ti ketë parasysh kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe të bëjë vlerësimin në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues i sqaron AK-së që të ketë parasysh nenin 1 të LPP-së, pasi që qëllimi i këtij ligji është që autoritetet kontraktuese të sigurohen që të përdorin fondet publike në mënyrën më ekonomike, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK "KK-Gjilan";
- 1x1 OE "Bejta Commerce" - SH.A- Gjilan;
- 1x1 OE "El Bau & Sinani Ing" SH.P.K,-Gjilan;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.